

DEKLARATE PER MEDIAN
MBI E CURINE E AKTIVITETEVE PER ANETARESIMIN E SHQIPERISE NE
NISMEN PER TRANSPARENCE NE INDUSTRIE NXJERRESE (EITI)

Realizimi i objektivave afatgjata të zhvillimit, objektivave afatmesëm, proceseve dhe synimeve evropiano-integruese të Shqipërisë, e gjejne sot vendin me një program të qartë, të integruar e të mbështetur në objektiva dhe politika të qarta që garantojnë zhvillimin e aktiviteteve në fushën e burimeve natyrore si aktivitete fitimprurës, mbështetës të prioriteteve kryesore të zhvillimit, sigurues të ritmeve të një rritjeje të qëndrueshme e përfshirëse e garantues kryesor për përmirësimin e klimës së biznesit në këtë sektor.

Shqipëria është pranuar si vend kandidat zbatues i kësaj nisme në 15 Maj 2009 në mbledhjen e Bordit Drejtues të EITI me votim unanim për realizimin në një kohë shumë të shpejte dhe me shumë korrektesë të hapave për fitimin e statusit të kandidatit. Për marrjen e këtij statusi Shqipëria realizoi 4 hapat e pare që kishin të bënin me:

1. Deklarimin Publik të shprehjes së dëshirës për të qenë anetare të kësaj nisme
2. Deklarimin për të punuar në bashkëpunim me grupet e interesit dhe shoqëri civile në realizimin e hapave të anetaresimit.
3. Përcaktimin e një kordinatori për ndjekjen e aktiviteteve që do të ndermeren në kuadrin e kësaj nisme.
4. Paraqitjen e kërkesës pranë bordit të nismës së bashku me një Plan veprimi me kostot dhe afatet për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga anetaresimi në këto nisme.

Me tej në vazhdim të zbatimit të hapave të 5 dhe të 6 Shqipëria me Urdhërin e kryeministrit Nr. 156, datë 27.12. 2008 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit nderinstitucional të punës, për ndjekjen e procedurave të kandidimit të Shqipërisë në Nismën për Transparenca në Industrinë Nxjerrëse (EITI)” ka krijuar grupin e punës ku Kryetar është caktuar zëvendës Ministri Z.NERITAN ALIBALI dhe Kordinator Z.Sokol MATI, janë përcaktuar anetarët e grupit të punës, janë ftuar në mbledhjen e grupit të punës të datës 16 mars 2009 rreth 95% e prodhuesve nga industria e naftës dhe 55 % nga ajo minerare si BANKERS PETROLEUM, ALBPETROL SHA, ALBANIAN CHROME shpk, SELENICE BITUMI SH.A., BERALBI SH.A., ALBA-CANAJ SHPK, 11 HERONJT BATER SHPK, dhomat e tregëtisë, nga shoqëria civile

EITI është një koalicion i përbërë nga qeveri, kompani, shoqëria civile, investitorë, organizma ndërkombëtare të cilët kanë zhvilluar një metodologji të saktë dhe fleksibile për monitorimin e pagesave ndërmjet kompanive dhe qeverive dhe të ardhurave nga industria nxjerrëse. EITI përdor standartet ndërkombëtare dhe promovon transparençën e të ardhurave nga industria nxjerrëse në nivel lokal dhe global. Tony Blair ka deklaruar këto inisiativa (Extractive Industries Transparency Initiative, EITI) në samitin botëror për zhvillim të qëndrueshëm në tetor 2002 në Johannesburg. Në qershor 2003 në konferencën e pare plenare të EITI të mbajtur në Lancaster House në Londër quhet dita e fillimit të kësaj nisme dhe në Qershor 2006 u përcaktua Oslo, si vendi ku do të zhvilloheshin aktivitetet e tij sekretariatit ndërkombëtar i kësaj nisme dhe u përcaktua bordi drejtues i saj.

EITI përbëhet nga vende kandidatë të pasura me burime natyrore (26 vende nga kontinenti i Amerikës Jugore, Afrika, Azia dhe Europa Peru, Kazakistan, Kamerun, Cote d’Ivoire, Democratic Republic of Congo, Equatorial Guinea, Gabon, Ghana, Guinea, Kirgizstan, Liberia,

Madagascar, Mali, Mauritania, Mongolia, Niger, Nigeria, Republic of the Congo, Sao Tome e Principe, Sierra Leone, Timor-Leste, Yemen, Norway), vende qe kane kryer periudhen e vleresimit (Azerbaijan) dhe vende mbeshtetese(14 shtete si Australia, Belgium, Canada, France, Germany, Italy, The Netherlands, Norway, Spain, USA, UK), shume shoqeri qe kryejne aktivite ne industrine nxjerrse si grupe interesi dhe grupe nga shoqeria civile.

Aktivitetet e kryera per anetaresimin si vend zbatues i Shqiperise ne Nismen per Transparence ne Industrite Nxjerrse (EITI) u iniciuan me letren e kryeministrit derguar Z. PETER EIGEN ne 16 Janar 2009, ne te cilen Qeveria Shqiptare shprehu deshiren qe Shqiperia te ishte anetare ne kete nisme si vend zbatues i kesaj nisme dhe pergjigja e ardhur nga Z. PETER EIGEN Kryetar i Bordit te kesaj nisme konfirmojne se pas realizimit te kushteve paraprake bordi mirepret hyrjen e Shqiperise ne kete nisme.

Ne kuader te gjithë procesit te reformimit pjesemarrja ne kete nisme do ti sherbeje:

- ✓ mireqeverisjes dhe opsioneve optimale te zhvillimit per perfitim sa me te madh te shtetasve shqiptar,
- ✓ gjithëpërshirje te grupeve te interesit dhe publikut ne vendim-marrje,
- ✓ rritje te transparences ne vendim marrje,
- ✓ vazhdimesi te reformave,
- ✓ nje zhvillim te qendrueshem,
- ✓ shfrytëzim racional te pasurive natyrore si pasuri te paperseritshme,
- ✓ rritje te punesimit dhe ulje te varferise,
- ✓ pergatitje te burimeve njerezore,
- ✓ ristrukturim te kapitalit qe trajton nxjerrjen e lendeve te para
- ✓ rivleresim te pasurive dhe planifikim te teritorit.
- ✓ permiresimin e bilancit ekonomik te vendit,
- ✓ respekt te ambientit ku jetojme

Aderimi ne kete inisiativë do te permiresoje klimen e biznesit te huaj ne sektorin minerar, do te rris investimet ne kete sektor, ajo krijon kushte per nje pjesemarrje me te gjere te biznesit vendas ne veprimtarite minerare, mundesi per gjetje te donatoreve per financime te ndryshme ne permiresim legjislacioni apo projekte te tjera qe lidhen me aktivitetet minerare kryesisht ne fushen e krijimit te maredhenjeve te organeve qeveritare me publikun, menyren e informimit, transparences, pjesemarrjen e opinionit te komunitetit ne vendim-marrje, etj

Shqiperia ka hyre ne procesin e vleresimit, proces i cili zgjat dy vjet. Gjate periudhes dyvjecare te procesit te vleresimit duhet te realizohen dhe 12 hapa per te fituar te drejta te plota si vend zbatues anetare i kesaj nisme.

Qe pas miratimit si vend kandidat grupi i punes ka realizuar draftet perkatese te formave te raportimit te cilat jane nisur per komente grupeve te interest dhe disa perfaqsesve te shoqerise civile, po punohet per zgjerimin e perfshirjes te sa me shume perfaqsesve nga shoqeria civile, pjesa akademike, universitetet, eksperteve te pavarur, perfshirjen 100 te kompanive nxjerrse minerare dhe te naftes e gazit, fillimit te plotesimit te raporteve, dhe nje kontakti me te madh me publikun si nje nga format efikase te rritjes se transparences.

Tirane, me 04.06.2009